



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Fonetikë e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore në klasë, 15 leksion dhe 25 seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti 1, sem 1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor Gjuhë angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndor: T'i ndihmojë studentët shqiptarë të përmirësojnë shqiptimin e tyre në gjuhën angleze, duke u fokusuar në tingujt karakteristikë të saj. T'u mësojë studentëve parimet dhe konceptet themelore të fonetikës dhe fonologjisë, përmes një baze teorike dhe praktike. T'u zhvillojë studentëve njohuri për të analizuar dhe krahasuar sistemin fonetik të anglishtes me atë të shqipes. T'u ofrojë studentëve aftësi për të aplikuar njohuritë në kërkime shkencore në fushën e fonetikës dhe fonologjisë. T'i pajisë studentët me kompetenca të domosdoshme për të kuptuar dallimet ndërmjet varianteve të ndryshme të gjuhës angleze, si ajo britanike dhe ajo amerikane.

Objektivat specifike lëndorë:

1. T'u mësojë studentëve terminologjinë bazë të fonetikës dhe fonologjisë.
2. T'i orientojë studentët në përdorimin e transkriptimit fonetik dhe alfabetit fonetik të gjuhës angleze.
3. T'u mësojë studentëve tiparet prozodike të ligjërimit (theksi, ritmi, intonacioni), duke i krahasuar me gjuhën shqipe.
4. T'u ngulitë studentëve tiparet fonetike karakteristike të anglishtes që janë të ndryshme nga shqipja.
5. T'u sqarojë studentëve ndryshimet në shqiptim ndërmjet varianteve britanike dhe amerikane të anglishtes.

Rezultatet e të nxënit:

1. Studenti përmirëson shqiptimin e tingujve, zotëron tiparet e vecantitë e theksit, ritmit, intonacionit të gjuhës angleze;
2. Studenti mëson të transkribojë saktë në gjuhën angleze;
3. Studenti mëson dhe përvetëson dallimet në shqiptim ndërmjet anglishtes britanike dhe amerikane;
4. Studenti mëson tiparet prozodike të ligjërimit në gjuhën angleze nën këndvështrimin përqasës e krahasues me gjuhën shqipe;
- 5.. studenti bën punë kërkimore duke përdorur metoda përqasëse krahasuese.